



**Alvesta
kommun**

Akomodim afatshkurtër

Informacion nga adminstrata e kujdesit



Akomodim afatshkurtër

Qëllimi i akomodimit afatshkurtër është të ju ofrojë siguri më të madhe në rast të ngjarjeve të paparashikuara. Qëllimi është që ju të jeni në gjendje të ktheheni në shtëpinë e juaj.

Akomodimi afatshkurtër është për ju, që për shembull:

- banoni në shtëpinë e juaj, por keni nevojë të qëndroni në akomodim afatshkurtër vetëm në ndonje periudha ose ne periudha të përsëritura
- mbështetet nga të afërmit në shtëpi që kanë nevojë për lehtësim
- pas një qëndrimi në spital, i paaftë për të shkuar direkt në shtëpinë tuaj

Kohëzgjatja e qëndrimit afatshkurtër mund të ndryshojë, por vendimi është gjithmonë i kufizuar në kohë. Akomodimet afatshkurtra janë në dispozicion në të gjitha shtëpitë e te moshuarve në komun.

Aplikimi

Aplikimin për akomodim afatshkurtër e bëni te assistenja (handläggaren). Pas aplikimit tuaj, bëhet një hetim sipas Aktit të Shërbimeve Sociale (SoL) ose Aktit të Shërbimeve për persona me aftësi të kufizuara (LSS). Hetimi bëhet së bashku me ju dhe, nëse është e nevojshme, edhe në bashkëpunim me, te afërmit, qendren shëndetësore, spitalin dhe autoritete te tjera. Nga hetimi i bërë merrët vendimi nëse ju keni nevojë për akomodim afatshkurtër ose nëse nevojat tuaja mund të plotësohet në një mënyrë tjetër. Kur përfundon hetimi do të merrni një mesazhvendimi me shkrim.

Apel ndaj vendimit

Nëse vendimi përmban një refuzim ose refuzim të pjesshëm, ju mund të apelonit ndaj vendimit. Nga asistentja juaj ju do të merrni informacion, mbështetje dhe këshilla se si të apelonit.

Të banosh në një akomodim afatshkurtër

Te gjitha akomodimet aftashkurtra ne komunen e Alvestës ju japin akses për kujdës dhe mbështetje gjat gjith orëve. Akomodimi i afatshkurtër është një dhomë e mobilizuar, me akses te alarmit për siguri. Nëse largoheni nga akomodimi afatshkurtër për një qëndrim në spital ose institucion tjetër, atëherë ju nuk do ta mbani vendin tuaj në atë akomodim.

Keto gjera do ju duhen me veti:

Rroba dhe kepuce për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm

- Artiklla higjienike personale
- Medikamentet aktuale, recetat, listën e barnave dhe çdo dozë
- Aparatet per mospërmbajtje
- Mjetet të testuara në mënyrë individuale

Plani i zbatimit

Per ty që vjen në një akomodim afatshkurtër krijohet një plan i zbatimit bazuar në nevojat tuaja. Plani i zbatimit është një marrvëshje me ty për mënyrën se si mund të formohet ndihma dhe mbështetja bazuar në ndihmën që ju keni të drejtë. Praktikisht, kjo do të thotë që ne do të sigurojmë mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme për t'ju bërë të ndiheni të sigurt dhe të jeni në gjendje të jetoni një jetë të pavarur sa më gjate dhe që para së gjithash të jeni në gjendje të ktheheni në shtëpinë tuaj. Plani ndiqet dhe ndryshohet sipas nevojës.

Kordinator

Ne caktojm një kordinator që do ju ndihmon në atë që vlen për rehatin dhe mirëqënien tuaj. Së bashku me ju, kordinatori do të hartojë një plan zbatimi që ju rregullisht do ta përcillni dhe vlerësoni. Kordinatori është gjithashtu ai që kryesisht nese është e nevojshme do të ketë kontakt me familjën ose perfaqësuesit e tuaj.

Familjarët

Ne i shohim familjarët si një burim në punën e kujdesit dhe ne shpresojmë që ju si një familjar gjithmonë të ndjeheni të mirëseardhur këtu sa herë që keni dëshirë. Mbani në mend që stafi nuk mund t'ju zëvendësojë kurrë. Ne urojmë që ju do keni mundësi të vini në vizitat mjekësore dhe dentare. Në radhë të parë, drejtohuni te grupi i stafit nëse keni ndojnë pyetje.

Pagesat

Pagesa për të banuar në akomodim afatshkurtër përbëhet nga pjesë të ndryshme:

- Pagesa për kujdes personal
- Pagesa për pako higjienike (qarqafë, peshqirë, materiale pastrimi)
- Pagesa për shpenzimet e ushqimit (pension i plote)

Më shumë informacion në lidhje me pagesat aktuale gjenden në broshurën e komunës *Taxa för hemtjänsten*.

SAS

Kordinatori Social Përgjegjës (SAS), ka përgjegjësinë e përgjithshme për zhvillimin e kualitetit të përmbajtjes sociale në komunë, gjithashtu heton komentet, ankesat dhe keqtrajtimet.

MAS

Infërmierja e Përgjegjshme Mjekësore (MAS), ka përgjegjësinë e përgjithshme të rishikimit për sigurinë e kujdesjes dhe kualitetit, gjithashtu heton komentet, ankesat dhe lëndimet serioze, sëmundjet dhe incidentet.

MAR

Përgjegjësi Rehabilitimi Mjekësor (MAR) ka përgjegjësinë e përgjithshme për të siguruar që pacientët të marrin një rehabilitim të sigurt dhe të duhur me kualitet të mirë.

E rëndësishme të dini

Ne në komunën e Alvestës dëshirojmë të sigurojmë kujdes të mirë, siguri dhe shërbim. Prandaj, është e rëndësishme që ne të dimë se çfarë ju mendoni për kontaktin që keni me ne.

Komentet, ankesat ose sugjerimet

Komuna e Alvestë ka si qellim të ofrojë cilësi të mirë në të gjitha departetet. Komentet, sugjerimet dhe ankesat përdoren në punën e zhvillimit të departeve. Më shumë informata mund të gjenden në broshurën e administratës të kujdesit. *Hjälp oss att bli bättre.*

Njoftimi për keqtrajtim

Stafi është i detyruar të raportojë keqtrajtim ne pun sipas dy paragrafëve të mëposhtëm:

Lex Sarah

”Gjithkush që është aktiv në kujdesin e të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara është i detyruar t’i mbikëqyrë këto

- merr kujdes të mirë dhe jeton në kushte të sigurta (SoL 14: 2)*
- merr mbështetje të mirë, shërbim të mirë dhe jeton në kushte të sigurta (LSS 24: a) ”.*

Lex Maria

”Lëndimet, sëmundjet dhe incidentet e rënda që ndodhin në kujdesin shëndetësor duhet t’i raportohen Bordit Kombëtar të Shëndetit dhe Mirëqenies (Ligji mbi Shëndetin dhe Mjekësinë 5)”

Bordi i Pacientëve

Nëse problemet nuk zgjidhen, ju ose ndonjë palë e ndërlidhur mund të kontaktojë me Bordin e Pacientëve, i cili ka për detyrë t'ju ndihmojë me çështjet që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Konfidencialiteti

Te gjithë puntorët brenda administratës kanë konfidencialitet. Kjo do të thotë që askush nuk mund të zbulojë informacione për gjendjen tuaj të jetës dhe për kujdesin dhe trajtimin që keni nga ne pa e lejuar ju atë.

Shkëmbimi i informacionit nganjëherë ndodh midis dy autoriteteve në kuadër të kujdesit shëndetësor dhe mjekësor dhe për shërbimet sociale ose nga shërbimet sociale në shëndetësi dhe kujdes mjekësor. Individu duhet, së pari, të pranojë dorëzimin e informacionit. Nëse individ nuk është në gjendje të japë pëlqimin e tij/saj, atëherë do të bëhet një rishikim (menprövning). Për shembull, mund të jetë një person dement ose pa vetëdije. Rishikimi (menprövning) do të thotë se personeli shëndetësor ose personeli i shërbimeve sociale vlerëson se informacioni në lidhje me individin është aq i rëndësishëm dhe që informacioni duhet të zbulohet që shërbimet sociale ose shërbimet shëndetësore dhe mjekësore të jenë në mundësinë të përmbushin punën e tyre. Kjo vlerësohet në secilin rast individual.

Lista e telefonave

Kommunens växel

Måndag – fredag dagtid 0472-150 00

Biståndshandläggare

Moheda, Mistelås och Slätthög 0472-59 56 34

Alvesta Östra, Lekaryd, Härlöv och Hjortsberga 0472-150 48

Alvesta Centrum 0472-153 75

Alvesta Centrum och Benestad 0472-151 25

Vislanda och Blädinge 0472-59 56 04

Grimslöv 0472-155 95

Lönashult–Västra Torsås 0472-155 95

LSS-handläggare 0472-151 87

Äldreboende

Furuliden ,Torpsbruksvägen 18, 340 36 Moheda 0472-59 56 60

Högåsen, Gemlavägen 1, 342 35 Alvesta 0472-151 00

Björkliden, Sockenvägen, 340 30 Vislanda 0472-59 56 00

Asken, Hantverkargatan 4, 340 32 Grimslöv 0472-59 56 82

Torsgården, Lönashultsvägen 27, 342 53 Lönashult 0472-59 56 50

SAS 0472-155 28

MAS 0472-154 64

MAR 0472-153 80

Patientnämnd 0470-58 85 42, 58 85 43



Alvesta kommun

Omsorgsförvaltningen

Besöksadress: Gärdesvägen 2, 342 80 Alvesta

Telefon 0472-150 00 växel

E-post: omsorg@alvesta.se

Ansvarig nämnd: Omsorgsnämnden